



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 197

Tiranë – E mërkurë, 15 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

| | Faqe |
|--|--|
| Vendim i Kuvendit, nr. 107/2017, datë 9.11.2017 | Për lirim nga detyra të një anëtar, i caktuar Kryetar, të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare... 9523 |
| Vendim i Kuvendit, nr. 108/2017, datë 9.11.2017 | Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi..... 9523 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 66, datë 10.11.2017 | Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 178, datë 25.1.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe nr. 00-2015-2123, datë 29.6.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 9524 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 67, datë 10.11.2017 | Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2016-26, datë 14.1.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 199, datë 17.4.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër..... 9530 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 68, datë 10.11.2017 | Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë..... 9535 |
| | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Bruzja..... 9539 |
| | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Petro Rondo..... 9539 |



VENDIM
Nr. 107/2017

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË
ANËTARI, I CAKTUAR KRYETAR,
TË KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 116, pika 1, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Piro Xhixho lirohet nga detyra e anëtarit, të caktuar Kryetar, të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.11.2017

VENDIM
Nr. 108/2017

PËR PROCEDURËN PARAPRAKE TË
PËRZGJEDHJES SË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 23, 25 e 29, të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në zbatim të neneve 19, pika 1, e 34 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet procedura paraprake e përzgjedhjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas fazave të mëposhtme:

a) Nga shërbimet e Kuvendit bëhet shpallja dhe bërja publike e vakancës së organit të krijuar me ligj nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik), për një afat prej 20 ditësh nga publikimi. Në shpallje të përcaktohet edhe dokumentacioni që duhet të shoqërojë CV-në e kandidatit për përmbushjen e kriterëve ligjore, si dhe pëlqimi i kandidatit me shkrim.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, lista me kandidaturat e vetofruara u bëhet e njohur anëtarëve të Kuvendit.

c) Shërbimet e Kuvendit, brenda 5 ditëve nga dërgimi i njoftimit të deputetët i listës së kandidaturave të vetofruara, organizojnë dëgjuesën publike në mjediset e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit njoftojnë të gjithë deputetët/grupet parlamentare për ditën, orën dhe mjediset ku do të kryhet dëgjesa publike dhe prezantimet e çdo kandidati në këtë proces të hapur.

ç) Pas dëgjësës publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, të cilët do të mbështesin për t’ia paraqitur Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.

d) Kandidaturat që do të marrin mbështetjen e jo më pak se 28 deputetëve, depozitohen zyrtarisht në protokollin e Kuvendit dhe vazhdojnë procedurat e parashikuara në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit.

II. Procedura paraprake e propozuar në pikën I, të këtij vendimi, nuk është e detyrueshme për t’u ndjekur nga deputetët, si dhe nuk përjashton në asnjë rast që të paktën 28 deputetë t’i paraqesin Kuvendit një kandidat që është përzgjedhur prej tyre jashtë procedurës së sipërcituar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 9.11.2017



VENDIM

Nr. 66, datë 10.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|-----------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vladimir Kristo | anëtar i | “ | “ |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | “ | “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ | “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ | “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ | “ |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.7.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 26 akti, që u përket:

KËRKUES: Piro Haxhistasa, Mirko Haxhistasa, Vangjel Haxhistasa, Koli Papa

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Piro Aleks, Milto Aleks, Katerina Aleks, Atjanka Aleks, Llambi Aleks, Odeta Aleks, Eleonora Aleks, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Shoqëria “A.B.A.U.” sh.p.k., Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr.178, datë 25.1.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe nr. 00-2015-2123, datë 29.6.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 49/e dhe 86/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Piro Aleks etj., të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesit janë trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit S.P., i cili ka qenë pronar i një sipërfaqeje truallit prej 1035 m², e ndodhur në Tiranë dhe e regjistruar në regjistrat përkatës. Rezulton se në datën 25.7.1938, ndërmjet shtetasit S.P. (trashëgimlënësi i kërkesve), në cilësinë e qiradhënësit, dhe shtetasit Ll.A. (trashëgimlënësi i personave të interesuar), në cilësinë e qiramarrësit, është lidhur një kontratë qiraje që kishte për objekt dhënien me qira të sipërfaqes së truallit të sipërcituar për një periudhë 99-vjeçare, me çmim të përcaktuar dhe me qëllim përdorimin e saj për ndërtim.

2. Rezulton se kjo kontratë qiraje nuk është realizuar për shkak të ndryshimit të regjimit juridik të tokës pas vitit 1944, gjë që solli ndryshimin e legjislacionit ku bazohet kjo kontratë qiraje, Kodin Civil të vitit 1929, duke e shfuqizuar dhe shuarjen e së drejtës së pronësisë mbi tokën për shkak të miratimit të Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1976.

3. Pas miratimit të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, trashëgimtarët ligjorë të shtetasit Ll.A. (subjektet e interesuara) i janë drejtuar Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (KKKP) Tiranë, i cili, me vendimin nr. 93, datë 30.6.1995, ka vendosur që të njohë të drejtën e përdorimit të truallit dhe ndërtimit në favor të tyre, në bazë të kontratës së qirasë të mësipërme. Po ashtu rezulton se mbi kërkesën e kërkesve (trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit S.P.), KKKP-ja Tiranë, me vendimin nr. 256, datë 4.10.1995, duke iu referuar kontratës së qirasë të vitit 1938, ka vendosur që t’u njohë dhe t’u kthejë pas 99 vjetësh truallin e lirë prej 1035 m² në pronësi të trashëgimlënësit të tyre.

4. Në datën 25.10.1997, subjektet e interesuara Aleks dhe subjekti i interesuar shoqëria “A.B.A.U.” sh.p.k. (ish-shoqëria “Leskova” sh.p.k.) kanë lidhur një kontratë bashkëpunimi nëpërmjet së cilës i vinin kësaj të fundit në dispozicion truallin e lirë prej 1035 m², me qëllim ndërtimin e një godine shumëkatëshe. Në këmbim, sipas kësaj kontrate, trashëgimtarët Aleks do të përfitonin 21% të sipërfaqes së ndërtimit për secilin kat dhe për bodrumin.



5. Këshilli i Rregullimit të Territorit Tiranë, bazuar mbi këtë kontratë bashkëpunimi, në bazë të ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993, “Për urbanistikën”, ka miratuar sipas formularit nr. 2 dhe formularit nr. 4, vendimin nr. 4489 prot., datë 11.6.1998, për dhënie e sheshit të ndërtimit, si edhe lejen e ndërtimit nr. 110, datë 21.2.1998, për ndërtimin e një godine 8-katëshe. Pas ndërtimit, ajo është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë, nga ku 79% e sipërfaqes ndërtimore të kësaj godine është regjistruar në favor të subjektit të interesuar, shoqëria “A.B.A.U.” sh.p.k., ndërsa 21% e sipërfaqes ndërtimore i është kaluar në pronësi subjekteve të interesuara Aleksis.

6. Kërkesit i janë drejtuar gjykatës me padi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KKKP-së Tiranë nr. 93, datë 30.6.1995, ndryshimin e vendimit të KKKP-së nr. 256, datë 4.10.1995, dhe kthimin e pronës kërkesve, detyrimin e subjekteve të interesuara (të paditur në procesin civil) që t'i njohin kërkesit pronarë mbi truallin me sipërfaqe 1035 m² dhe mbi 21% të sipërfaqes së godinës, si edhe kthimin e tyre kërkesve.

7. Me vendimin nr. 3648, datë 16.4.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të padisë. Anulimin e vendimit nr. 93, datë 30.6.1995, të KKKP-së Tiranë. Ndryshimin e vendimit nr. 256, datë 4.10.1995, të KKKP-së Tiranë, duke hequr kushtin e kthimit të pronës paditësve pas 99 vjetëve, e duke e lënë në fuqi për pjesën tjetër... Rrëzimin e kërtimeve të tjera.”*

8. Me vendimin nr. 178, datë 25.1.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj e prova. Kundër këtij vendimi, kërkesit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

9. Me vendimin nr. 00-2015-2123, datë 29.6.2015, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

10. **Kërkesit Piro Haxhistasa etj.** i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

10.1 Është cenuar e drejta e pronës private nëpërmjet akteve të pushtetit publik, që janë vendimet gjyqësore objekt kërkesë. Gjykatat nuk janë mbështetur në nenin 13 të KPC-së, por ato kanë pranuar se kontrata e vitit 1938, që rregullohej në bazë të dispozitave të Kodit Civil të vitit 1929, është ende e vlefshme, edhe pse pas vitit 1944 këto dispozita u shfuqizuan. Të vetmet dispozita të Kodit të vitit 1929 që mund të gjejnë zbatim edhe në ditët e sotme janë ato për trashëgiminë. Gjykatat nuk patën parasysh as dispozitat e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës dhe në kundërshtim flagrant me to pranuan se kontrata e lidhur për 99 vjet është e ligjshme dhe e vlefshme. Po ashtu, ato kanë vepruar edhe në kundërshtim me ligjin për urbanistikën, pasi kërkesën për leje ndërtimi mund ta bënte vetëm pronari. Për arsye se gjykatat e zakonshme nuk u mbështetën në këto dispozita, subjektet e interesuara, në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës, janë bërë pronarë të truallit dhe godinës së ndërtuar mbi të.

10.2 Interpretimi që Gjykata e Apelit u ka bërë neneve të Kodit Civil të vitit 1929 është një interpretim dhe zbatim haptazi i gabuar i tij, që ka çuar në cenimin e së drejtës së pronës, pasi si pasojë e tij kërkesve u është shuar e drejta e pronësisë. Gjykata ka vepruar në kundërshtim me interpretimin dhe zbatimin që u kanë bërë këtyre dispozitave Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 46, datë 10.4.2001, i cili nuk është marrë parasysh thjesht me argumentin se ai nuk është vendim unifikues.

10.3 Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ky cenim konstatohet në aspektin e përmbajtjes dhe të lejimit të kontradiktave në vendimin e kundërshtuar. Në vendimin e saj, për sa i përket aspektit faktik të gjykimit, duke iu referuar kontratës së qirasë të vitit 1938, të lidhur mes shtetasve S.P. dhe L.L.A., Gjykata e Apelit pohon se e drejta që kishte fituar trashëgimlënësi i subjekteve të interesuara ka qenë një e drejtë subjektive e kufizuar në kohë, për 99 vjet, dhe se kjo kontratë nuk e ka



humbur fuqinë e saj juridike. Nga ana tjetër, ajo gjykatë, në kundërshtim të hapur me sa ka konstatuar vetë, u ka njohur subjekteve të interesuara të drejtën absolute dhe ekskluzive të pronësisë mbi truallin dhe sipërfaqen ndërtimore të ngritur mbi të, duke zhveshur kërkuesit, trashëgimtarë të ish-pronarit S. P., përfundimisht nga e drejta e pronës.

10.4 Është cenuar e drejta e aksesit dhe e ankimit në gjykatë. Kërkuesit, bazuar në nenin 472 të KPC-së, i kanë ngritur në rekurs pretendimet për cenimin flagrant, të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë të së drejtës kushtetuese të pronës private, si pasojë e interpretimit dhe zbatimit haptazi të gabuar të dispozitave të Kodit Civil të vitit 1929, dhënien fuqi të kontratës së qirasë të vitit 1938 në një kohë që dispozitat e këtij Kodi janë shfuqizuar, moszbatimin e dispozitave të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave etj. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, edhe pse gjykatat e faktit kishin mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta mbi këto çështje, duke dhënë zgjidhje të ndryshme, vendosi mospranimin e rekursit. Ky është vendim standard formal mospranimi, i cili nuk përmban asnjë arsytim jo vetëm për të kuptuar shkaqet e këtij qëndrimi, por edhe për ta përligjur vendimmarrjen e tij. Në kushtet kur në rekurs ishin ngritur pretendime të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit duhej të investohej në shqyrtimin e tyre dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to.

11. **Subjektet e interesuara Piro Aleksii etj.**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës kanë parashtruar sa vijon:

11.1 Ajo që paraqitet nga kërkuesit si shkelje e së drejtës së pronës është veçse një çështje e natyrës civile/private, e cila, megjithëse veçanërisht komplekse, nuk lidhet me aspektin kushtetues dhe të drejtën e pronësisë si një liri thelbësore. E drejta e sipërfaqes sipas doktrinës juridiko-civile është një servitut, një barrë, një e drejtë reale dhe për këtë shkak ajo regjistrohet. Trashëgimtarët e shtetasit Ll. A. janë bërë pronarë të ndërtimit të ngritur, por jo të truallit, tamam ashtu siç ishte rënë dakord në kontratën e vitit 1938.

11.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur parimin e sigurisë juridike dhe të drejtësisë dhe kjo shkelje është rivendosur nga Gjykata e Apelit Tiranë. Edhe pse ligji nr. 7698, datë 15.4.1993, nuk parashikon restaurimin e të drejtave reale mbi sendet e të tretëve në mënyrë të shprehur, nuk e ndalon atë në asnjë mënyrë dhe mbi të gjitha aplikimi i tij duhet të jetë i tillë që të rivendosë atë gjendje juridike që ekzistonte përpara shtetëzimit.

11.3 Pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit gjyqësor është i palogjikshëm dhe nuk gjen vend në zhvillimin e procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

11.4 Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të ankimit në gjykim është i pabazuar. Gjykata e Lartë në vendimin e saj për këtë çështje ka plotësuar tërësisht standardet kushtetuese.

12. **Subjektet e interesuara, shoqëria “A.B.A.U.” sh.p.k., AKP-ja Tiranë dhe ZVRPP-ja Tiranë**, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim para Gjykatës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

13. Gjykata vëren se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në fuqi në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e ngritura në kërkesë janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor

14. Sipas kërkuesve është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi në vendimin e Gjykatës së Apelit konstatohen kontradikta. Sipas tyre, edhe pse ajo gjykatë pranon në vendim se e drejta që kishte fituar trashëgimlënësi i subjekteve të interesuara ka qenë një e drejtë subjektive e kufizuar në kohë, nga ana tjetër u ka njohur atyre të drejtën absolute dhe ekskluzive të pronësisë mbi truallin dhe sipërfaqen ndërtimore të ngritur mbi të. Duke mbajtur një qëndrim të tillë, si dhe duke mos pasur parasysh shfuqizimin e dispozitave të Kodit



Civil të vitit 1929 pas vitit 1944, si edhe dispozitat e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës dhe atij për urbanistikën, ajo u ka cenuar kërkuesve të drejtën kushtetuese të pronës private.

15. Gjykata, në analizë të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale, ka theksuar se vendimet gjyqësore duhet jenë të arsyetuara dhe të përmbajnë: një parashtrim të përmbledhur të rrethanave të faktit, provat mbi të cilat bazohen, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar dispozitat ligjore të zbatuara. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, që kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimin nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Zbatimin e këtij parimi Gjykata e ka vlerësuar rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, si dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 39, datë 25.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka theksuar se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të

vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vëren se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Apelit nga pikëpamja formale përmban në pjesën hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së rrethit dhe pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Edhe në aspektin substancial, ky vendim nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënë, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër, duke përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi. Gjykata e Apelit, pasi ka bërë një analizë të çështjes, duke vlerësuar zbatimin e dispozitave ligjore ndaj rrethanave të çështjes konkrete, ka arritur në përfundimin e shprehur në dispozitiv, duke paraqitur edhe argumentet e saj ligjore që kanë çuar në ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

19. Gjykata vlerëson se në thelb pretendimet e kërkuesve lidhen me mënyrën e zbatimit të ligjit dhe të interpretimit të tij nga ana e Gjykatës së Apelit, çështje që nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, por i përkasin juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se detyrë e kësaj Gjykate nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe të ankimit

21. Sipas kërkuesve është cenuar e drejta aksesit dhe e ankimit në gjykatë, pasi edhe pse ata, bazuar në nenin 472 të KPC-së, kanë ngritur në rekurs pretendime për cenimin e së drejtës



kushtetuese të pronës private, Kolegji Civil vendosi mospranimin e tij, edhe pse gjykatat e faktit kishin mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta mbi këto çështje, duke dhënë zgjidhje të ndryshme. Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit duhej të investohej në shqyrtimin e tyre dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to.

22. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit, si pjesë të pandara dhe garanci të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Sipas jurisprudencës kushtetuese, e drejta e ankimit duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 5, datë 2.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesit e kanë ushtruar lirisht të drejtën e aksesit dhe të ankimit nëpërmjet paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, por kjo e drejtë nuk presupozon që gjykata duhet ta kalojë çështjen në seancë ose të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast. Sipas nenit 480 të KPC-së është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të

vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr.19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Edhe në lidhje me arsyetimin e këtyre vendimeve të dhomës së këshillimit, Gjykata, bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka theksuar se detyrimi që ka gjykata vendëse për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës (*shih vendimin nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nisur nga natyra e pretendimeve të paraqitura në rekurs nga kërkuesit, arsyetimi i kufizuar i vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) nuk përbën një mangësi në përmbajtjen e vendimit të asaj gjykate. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje në kompetencat e saj ligjore dhe se vendimi i saj nuk vë në dyshim të drejtën e kërkuesve për një proces të rregullt ligjor.

26. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit dhe të ankimit nuk janë të bazuara dhe se kërkesa nuk duhet të pranohet.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha

Anëtarë pjesërisht kundër: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Siç rezulton nga vendimi, kërkesit kanë pretenduar se: “U është cenuar e drejta e pronës private, nëpërmjet akteve të pushtetit publik, që janë vendimet gjyqësore objekt kërkesë. Gjykatat nuk janë mbështetur në nenin 13 të KPC-së, por ato kanë pranuar se kontrata e vitit 1938, që rregullohej në bazë të dispozitave të Kodit Civil të vitit 1929, është ende e vlefshme, edhe pse pas vitit 1944 këto dispozita u shfuqizuan. Të vetmet dispozita të Kodit të vitit 1929 që mund të gjejnë zbatim edhe në ditët e sotme janë ato për trashëgiminë. Gjykatat nuk patën parasysh as dispozitat e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës dhe në kundërshtim flagrant me to pranuan se kontrata e lidhur për 99 vjet është e ligjshme dhe e vlefshme. Po ashtu, ato kanë vepruar edhe në kundërshtim me ligjin për urbanistikën, pasi kërkesën për leje ndërtimi mund ta bënte vetëm pronari. Për arsye se gjykatat e zakonshme nuk u mbështetën në këto dispozita, subjektet e interesuara, në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës, janë bërë pronarë të truallit dhe godinës së ndërtuar mbi të” (prg. 10, pretendimi 10.1. i vendimit).

3. Shumica ka analizuar pretendimet lidhur me arsyetimin, aksesin dhe ankimin, duke u shprehur se “pretendimet e kërkesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit dhe të ankimit nuk janë të bazuara dhe se kërkesa nuk duhet të pranohet” (prg. 26 i vendimit).

4. Sikundër konstatohet, shumica nuk ka marrë në analizë pretendimin e parë të kërkesve, që është pretendimi për shkeljen e së drejtës së pronës në dimension kushtetues, por u ka dhënë përgjigje vetëm pretendimeve të lidhura me procesin e rregullt ligjor procedural, qëndrim i cili nuk përfaqëson dhe nuk reflekton ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të reja të kompetencës së Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar pretendimet e individëve për cenimin e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë nëpërmjet një akti publik apo vendimi gjyqësor, siç është dhe e drejta e pronës private në rastin konkret.

5. Sipas nenit 131/1/f të Kushtetutës, përmbajtja e ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

6. Neni 71 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon: “Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i liritë themelore të parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji”.

7. Në mendimin tim, shumica nuk duhej të shmangte kompetencën e saj për kontroll substancial të procesit gjyqësor në drejtim të së drejtës së pronës private.

8. Nga sa më sipër, vlerësoj se ajo nuk ka zhvilluar një proces të drejtë gjyqësor ndaj kërkesve, në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës të lidhur me nenin 41, pikat 1 dhe 2



të saj. Gjykata Kushtetuese mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, që në parim u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit dhe jo vetëm ato të lidhura me procesin e rregullt ligjor procedural, sipas perspektivës së re të normave kushtetuese dhe ligjore mbi ankimin kushtetues individual.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 67, datë 10.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|----------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha, | anëtar i | “ | “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ | “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ | “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ | “ |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 5.10.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 47 akti, që i përket:

KËRKUES: Agron Laçaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 00-2016-26, datë 14.1.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr.199, datë 17.4.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr.110 (51-2012-1276), datë 28.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1/2, 43, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, Agron Laçaj, që kërkoji pranimin e

kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoji rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga dokumentet të cilat shoqërojnë kërkesën rezulton se kërkuari është gjykuar për veprat penale “Vrasje me dashje” dhe “Armëmbajtje pa leje”.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 226, datë 25.7.2000, ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Lan Laçaj për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Lan Laçaj për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Lan Laçaj për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, përfundimisht dënimin e të pandehurit Agron Lan Laçaj me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.*”.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.159, datë 15.12.2000, ka vendosur: “*Prishjen e vendimin nr. 226, datë 25.7.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues*”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.2.2012, ka vendosur: “*Deklarimin e pajajshëm të të pandehurit A.L. për veprën penale “Vrasje” së shtetasit L. H., parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal (KP). Deklarimin e pajajshëm të të pandehurit A.L. për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së, sipas nenit 388/d të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit personal në burg të caktuar ndaj të pandehurit A. L., të caktuar me vendimin nr. 2, datë 2.3.2000, të Gjykatës së Apelit Shkodër.*”.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 199, datë 17.4.2014, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 110 (51-2012-1276), datë 28.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në këtë mënyrë: Deklarimin fajtor të të pandehurit A. L. për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” në dëm të shtetasit S.*”.



R., parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit A. L. për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” në dëm të shtetasit L. H., parashikuar nga neni 76 i KP-së dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit A. L. për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së, dënimin përfundimisht të të pandehurit A. L. me 25 vjet burgim.”.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2016-26, datë 14.1.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

7.1 Është shkelur e drejta për t’u mos u deklaruar fajtor mbi akte absolutisht të pavlefshme dhe parimi i kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Apelit Shkodër ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke u dhënë vlerë provave të marra në mënyrë të paligjshme, të cilat gjykata e rrethit i ka deklaruar si të marra në shkelje të ndalimeve ligjore.

7.2 Është cenuar e drejta e aksesit dhe e drejta e mbrojtjes, pasi Gjykata e Apelit Shkodër nuk i ka komunikuar kërkuesit ankimin e bërë nga prokurori, si dhe nuk e ka njoftuar atë për datën dhe orën e seancës gjyqësore.

7.3 Është cenuar parimi i paanshmërisë dhe barazisë së armëve, pasi gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit, mbrojtësi i kërkuesit ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve V. V. dhe L. H., kërkesë e cila është rrëzuar nga një tjetër kolegji.

7.4 Është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të rekursit të bërë nga mbrojtja.

8. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

8.1 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i pabazuar, pasi nga materialet e dosjes konstatohet se kërkuesi

ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet, kundërshtimet dhe provat e tij. Ai është përfaqësuar gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër nga avokati S. A., i zgjedhur nga vetë kërkuesi.

8.2 Në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë dhe së drejtës së aksesit në gjykim, rezulton se Kolegji Penal, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore. Vendimi i këtij kolegji përmban palët, shkaqet e rekursit dhe të gjitha pretendimet e kërkuesit. Në fund, kolegji ka konkluduar se nuk ka shkaqe për të pranuar shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore, gjë e cila është tërësisht në juridiksionin e atij kolegji.

8.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të së drejtës për t’u mbrojtur. Nga verifikimi i fashikullit të gjykimit nga Gjykata e Apelit Shkodër, rezulton se kjo gjykatë ka kryer të gjitha njoftimet, në respektim të ligjit procedural penal. Për çdo seancë i ka dërguar njoftimet avokatit S. A., të caktuar nga vetë kërkuesi, si dhe i ka dërguar njoftimet kërkuesit nëpërmjet oficerit të Policisë Gjyqësore.

8.4 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, mënyra e vlerësimit të provave të administruara në gjykim nga ana e gjyqtarit apo mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit jo vetëm që janë çështje që nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, por ato nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur këtë pretendim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis* vërehet se vendimi i fundit i dhënë për kërkuesin është ai i datës 14.1.2016, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërsa kërkesa është paraqitur pranë Gjykatës në datën 31.5.2017. Nëpërmjet letrës shoqëruese dhe pagesës së postës nr. 0115901, datë 28.2.2017, kërkuesi provon se kërkesën e tij e ka dorëzuar në zyrën postare “TNT” në datën 28.2.2017, periudhë kjo në të cilën kanë qenë në fuqi dispozitat e vjetra ligjore, konkretisht neni 30 i ligjit nr. 8577, datë



10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikonte paraqitjen e kërkesës brenda afatit 2-vjeçar. Për sa më sipër, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* për t’iu drejtuar Gjykatës.

10. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individi përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe materialeve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se kërkuesi pretendimet e tij për cenimin e së drejtës së aksesit dhe asaj për t’u mbrojtur, si dhe për cenimin e parimit të paanshmërisë dhe të barazisë së armëve nuk i ka ngritur më parë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke mos shteruar kështu mjetet për t’iu drejtuar kësaj Gjykate në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës. Për këto arsye, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për këto pretendime.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

12. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit Shkodër ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke u dhënë vlerë provave të marra në mënyrë të paligjshme, të cilat Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër i ka deklaruar si të marra në shkelje të ligjit.

13. Gjykata ka theksuar se mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt. Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, që pa dëmtuar dhënien e “përmasës së duhur të drejtësisë”, të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme. Në bazë të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, gjykatat e kanë për detyrë të vlerësojnë në tërësi nëse procedurat lidhur me mënyrën se si janë siguruar provat kanë qenë të drejta. Nisur nga këto qëndrime të evidentuara në jurisprudencën europiane, Gjykata Kushtetuese e ka konsoliduar qëndrimin e saj, duke evidentuar dallimin që ekziston në një proces ligjor ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Vlerësimi i provave mbetet një çështje për t’u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit, mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrat e marrjes së provave, si dhe fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete (*shih vendimin nr. 7, datë 27.4.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si edhe referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës, vëren se në rastin konkret gjykata të niveleve të ndryshme kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes në ngarkim të kërkuetit. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se: “Nga procesverbali nuk rezulton që dëshmitarit Lan Laçaj, megjithëse ishte babai i të pandehurit, dhe sipas nenit 16 dhe 158 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kishte të drejtën për të mos dëshmuar, nga ana e policisë gjyqësore nuk i është marrë pëlqimi në mënyrë të shprehur nëse dëshiron apo jo të japë deklaramë lidhur me faktin. Pra, nuk rezulton që t’i jetë bërë me dije shprehimisht se ka të drejtë të mos dëshmojë dhe pastaj t’i merret shprehimisht pëlqimi duke u pasqyruar në procesverbal. Gjykata çmon se ky veprim procedural është realizuar në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji dhe si rrjedhojë rezultati i dalë prej



saj është i papërdorshëm... Nga procesverbalit rezulton që dëshmitarit Kreshnik Laçaj, megjithëse ishte vëllai i të pandehurit, dhe sipas nenit 16 dhe 158 të KPP-së, kishte të drejtën për të mos dëshmuar, nga ana e policisë gjyqësore nuk i është marrë pëlqimi në mënyrë të shprehur nëse dëshiron apo jo të japë deklaratime lidhur me faktin. Gjykata çmon se ky veprim procedural është realizuar në shkëlqje të ndalimeve të parashikuara nga ligji dhe si rrjedhojë rezultati i dalë prej saj është i papërdorshëm. Rezulton që të pavlefshme janë vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kërkesa për gjykim dhe vendimi për marrjen e personit si të pandehur”, duke vendosur në përfundim të gjykimit deklarin të pafajshëm të kërkuarit. Në ndryshim nga sa më sipër, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke deklaruar fajtor kërkuarin, si dhe duke vlerësuar se: “Në gjykim janë administruar thëniet e dëshmitarit Kreshnik Laçaj, vëllai i të pandehurit Agron Laçaj, të marra konform nenit 369 të KPP-së... Këto deklaratime vlerësohen nga gjykata për sa i përket autorësisë së vrasjes, për shkak se deklaratimet e këtij dëshmitari janë marrë në respektim dhe zbatim të nenit 158 të KPP-së, ku dëshmitarit që ka lidhje gjinore me të pandehurin i bëhet e ditur e drejta që ka për të mos dëshmuar dhe ky dëshmitar me vullnetin e tij ka dhënë deklaratimet e datës 22.12.1999. Mos pasqyrimi i nenit përkatës nuk e bën dëshminë të pavlefshme. Deklarimet e këtij dëshmitari të bëra në hetimet paraprake, duke u marrë në zbatim të nenit 369 të KPP-së, këmben në provë dhe shqyrtohen në tërësi me provat e tjera të marra në këtë gjykim për sa i përket provueshmërisë së autorit, por vlerësohen të pabesueshme thëniet e tij për sa i përket mekanizmit të vrasjes, ku ky dëshmitar është përpjekur që ta pozicionojë të pandehurin si vrasje e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Sa i përket arsytimit të gjykatës për pavlefshmëri të akteve të procedimit penal lidhur me përfundimet e hetimeve, njoftimin e kërkesës për gjykim, njoftimit të akuzës, vlerësimin të thënieve të dëshmitarëve Lal Laçaj e Kreshnik Laçaj, të bëra gjatë hetimeve paraprake, Gjykata e Apelit i gjen ato të drejta vetëm për sa i përket dëshmitarit Lan Laçaj, të cilat nuk janë marrë konform nenit 158 të KPP-së.”.

15. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit është e paqartë, pasi nuk shpjegon se pse ka pranuar deklaratimet e bëra nga dëshmitari Kreshnik Laçaj (vëllai i kërkuarit) dhe nuk ka pranuar deklaratimet e bëra nga dëshmitari Lan Laçaj (babi i kërkuarit), konstatim të cilin duhet ta kishte bërë dhe të ishte shprehur Gjykata e Lartë.

16. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (shih vendimin nr. 19, datë 2.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata rithekson se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (shih vendimin nr. 30, datë 30.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese).

17. Në jurisprudencën kushtetuese, çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor (shih vendimin nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

18. Gjykata vëren se, edhe pse në rekurs kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Apelit Shkodër i ka bërë një vlerësim të ndryshëm provave nga vlerësimi që ka bërë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari.

19. Gjykata vlerëson se, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat janë brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, si edhe bazuar në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes në fjalë, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta,



duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë ngre dyshime edhe në lidhje me respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

21. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej për to në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit.

22. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se në çështjen konkrete Gjykata e Lartë ka lejuar një proces të parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës, duke mos ushtruar funksionin e saj kontrollues për respektimin e standardeve kushtetuese të procesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2016-26, datë 14.1.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Agron Laçaj jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 00-2016-26, datë 14.1.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

2. Sipas shumicës, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, të cilat janë brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, si edhe bazuar jo vetëm në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes në fjalë, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t'u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

3. Duke qëndruar në linjë me qëndrimet e mia në pakicë në çështje të së njëjtës natyrë, edhe në rastin konkret dua të ritheksoj se sipas nenit 433 të KPP-së është në kompetencë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në shkaqet që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në



aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në kuptim të sa më sipër, jurisprudenca e Gjykatës ka ecur në linjën që një vendim gjyqësor i dhomës së këshillimit cenon të drejtën për një proces të rregullt në ato raste kur në procesin e zhvilluar në shkallët më të ulëta të gjykimit është konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese të individit, në një nga elementet përbërëse të saj, e cila është e vetmja e drejtë kushtetuese procedurale që i lejon individit të mbrojtë të drejtat e tjera të tij substanciale.

4. Por, në rastet kur Gjykata nuk konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit, ajo nuk vë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se kolegji ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi. Ky proces është vënë në dyshim nga Gjykata vetëm në rastin kur këto vendime nuk përmbajnë shkaqet e ngritura në rekurs, çka, sipas saj, përbën cenim të parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, edhe në lidhje me këtë parim, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson zbatimin e tij rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme këtë detyrim (*sib vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Bazuar në vendimet e kundërshtuara rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar të pafajshëm kërkuesin, duke vlerësuar se disa nga provat e administruara gjatë fazës së hetimeve paraprake janë marrë në mosrespektim të kërkesave ligjore, ndaj i ka konsideruar ato të pavlefshme. Në ndryshim nga kjo gjykatë, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se thjesht mospasqyrimi i dispozitës ligjore në dëshmi nuk e bën atë të pavlefshme dhe se deklaratimet e bëra në hetimet paraprake kthehen në provë dhe shqyrtohen në tërësi me provat e tjera të marra në këtë gjykim për sa i përket provueshmërisë së autorit. Po ashtu, Gjykata e Apelit nuk ka gjetur të drejtë as arsytimin e gjykatës së shkallës së parë për pavlefshmëri të disa akteve të procedimit penal. Në përfundim të

gjykimit, ajo gjykatë ka dhënë një vendim të arsytuar në lidhje me qëndrimin e mbajtur prej saj, për sa i takon pavlefshmërisë së dëshmvive dhe akteve procedurale, dhe ka arritur në përfundimin për fajësinë e kërkuesit bazuar në vlerësimin e shqyrtimin tërësor të të gjitha provave të administruara në gjykim, si dhe duke argumentuar qëndrimin e saj.

6. Për rrjedhojë, për sa kohë që në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit nuk vërehet asnjë shkelje që mund ta cenojë atë, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë nuk mund të vihet në dyshim. Gjykata e Lartë, duke vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, ka vlerësuar se ato janë të pabazuara dhe ka vendosur mospranim e rekursit.

7. Për sa më sipër, si gjyqtar në pakicë, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga Agron Laçaj është e pabazuar dhe se Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e saj.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 68, datë 10.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|----------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e | “ | “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ | “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ | “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ | “ |
| Fatmir Hoxha, | anëtar i | “ | “ |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 26.9.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr.42 akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Sulejman Cakoni

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kalosh Vata, Përmbaruesi privat Shpëtim Allamani

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.



BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuases, që kërkoji pranimin e kërkesës, pretendimet e subjekteve të interesuara, Kalosh Vata, përmbaruesit gjyqësor privat Shpëtim Allamani, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Sulejman Cakoni, me profesion avokat, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me padi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar Kalosh Vata për të paguar shumën prej 62.250 lekësh, si shpërblim për përfaqësimin në gjykimet e zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për çështjen me palë paditëse subjektin e interesuar dhe të paditur shtetasin I. V., Agjencinë e Trajtimit të Kredive dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. 61, datë 25.2.2014, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuarit, detyrimin e subjektit të interesuar për të paguar shumën 62.250 lekë, si rrjedhim të përfaqësimit si avokat.

3. Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 550, datë 27.2.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 61, datë 25.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

4. Kundër këtij vendimi nuk është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Në datën 27.2.2015, vendimi ka marrë formë të prerë dhe kërkuari i është drejtuar për ekzekutim përmbaruesit gjyqësor privat Shpëtim Allamani për të kryer veprimet e nevojshme procedurale.

II

5. **Kërkuesi Sulejman Cakoni** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe

nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

6. **Subjekti i interesuar Kalosh Vata** ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

6.1. Kërkuesi ka qenë përfaqësues vetëm gjatë gjykimin në gjykatën e rrethit dhe për shërbimin e kryer është paguar bazuar në një marrëveshje dhe jo sipas një kontrate të shkruar. Kërkuesi ka pasur detyrimin për të provuar se nuk është paguar, kurse vendimet gjyqësore janë të pabazuara në ligj dhe në prova, duke favorizuar kërkuesin për shkak të profesionit.

6.2. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është marrë pa praninë e palëve, duke mohuar të drejtën e tyre për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

6.3. Kërkuesi pretendon tarifa, të cilat janë vendosur në mënyrë të njëanshme prej tij dhe jo bazuar në ligj.

7. **Subjekti i interesuar, përmbaruesi gjyqësor privat Shpëtim Allamani**, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

7.1 Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor janë kryer të gjitha veprimet procedurale të parashikuara nga KPC-ja, duke filluar nga njoftimi për ekzekutimin vullnetar deri në vendosjen e sekuestros konservative në të gjitha bankat e nivelit të dytë për depozitat e kursimit apo llogaritë rrjedhëse ndaj subjektit të interesuar, por ka rezultuar se nuk disponon asnjë depozitë apo llogari rrjedhëse.

7.2 Në vijim të procedurave për ekzekutim është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros në ZVRPP-në Mat për pasurinë e paluajtshme apartament banimi, të cilin subjekti i interesuar e ka në bashkëpronësi me bashkëshorten dhe fëmijën. Përmbaruesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me kërkesë për veçimin e pjesës takuese të subjektit të interesuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim, por Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar akoma.

7.3 Pranë DRSHTRR-së Dibër është dërguar urdhri i sekuestros për çdo mjet motorik që mund të disponojë debitori, por është kthyer përgjigje se nuk ka asnjë mjet motorik në pronësi.



7.4 Debitori është pensionist dhe me probleme shëndetësore, si dhe nuk ka asnjë të ardhur përveç pensionit, ndaj të cilit nuk mund të vendoset sekuestro.

7.5 Ndryshe nga sa pretendon kreditori në kërkesë, nuk i është cenuar asnjë e drejtë, pasi janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme. Në rastin konkret derisa debitori nuk disponon asnjë pasuri, në bazë të kërkesave ligjore ekzekutimi i vendimit mund të pushohet ose pezullohet, por debitori ka shprehur vullnetin për likuidimin e detyrimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

8. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

9. Gjykata Kushtetuese (në vijim gjykata) ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

10. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit dhe të autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e kërkuesit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet

të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Ndërsa për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se nismat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr.1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata e vlerëson çështjen konkrete në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se kohëzgjatja do të merret nga data 27.2.2015, kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, deri në datën 24.4.2017, kur kërkesa është paraqitur para kësaj Gjykate.

i) Kompleksiteti i çështjes

12. Kërkesa në shqyrtim ka si objekt detyrimin e subjektit të interesuar për të paguar ndaj kërkuesit shumën prej 62 250 lekësh si pasojë e shërbimit të kryer me cilësinë e avokatit. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, çështja në shqyrtim nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Sjellja e kërkuesit

13. Kohëzgjatja për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e kërkuesit, të cilat mund të kenë çuar në mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji.

14. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka ndjekur të gjitha veprimet e nevojshme juridike për të finalizuar të drejtën e fituar.



15. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së cenuar dhe duke shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

iii) Sjellja e autoriteteve

16. Në këtë drejtim është e nevojshme fillimisht të vlerësohet nëse përmbaruesi gjyqësor privat Shpëtim Allamani ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Sipas kërkesës dhe dokumenteve bashkëlidhur rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale të parashikuara nga KPC-ja, duke filluar nga njoftimi për ekzekutimin vullnetar, deri te vendosja e sekuestros konservative në të gjitha bankat e nivelit të dytë për depozitat e kursimit apo llogaritë rrjedhëse të subjektit të interesuar, por ka rezultuar se nuk disponon asnjë depozitë apo llogari rrjedhëse.

17. Me shkresën nr. 718 prot., datë 25.5.2015, drejtuar DRSHTRR-së Peshkopi, përmbaruesi ka urdhëruar vendosjen e sekuestros konservative për çdo mjet motorik që mund të disponojë debitori. Me shkresën nr.168/1 prot., datë 10.6.2015, DRSHTRR-ja Peshkopi ka kthyer përgjigje se në emër të debitorit nuk figuron i regjistruar asnjë mjet motorik. Në vijim të procedurave për ekzekutim, me shkresën nr. 401 prot., datë 30.5.2015, është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros në ZVRPP-në Mat për pasurinë e paluajtshme apartament banimi, të cilin subjekti i interesuar e ka në bashkëpronësi me bashkëshorten dhe fëmijën. Përmbaruesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me kërkesë për veçimin e pjesës takuese të subjektit të interesuar, e cila ka vendosur pushimin e gjykimit. Ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim, por Gjykata e Apelit Tiranë nuk e ka shqyrtuar akoma.

18. Në datën 20.7.2015, përmbaruesi gjyqësor privat ka vënë në dijeni debitorin lidhur me detyrimin e tij dhe masat që do të marrë si pasoje e mosekzekutimit. Debitori është shprehur se për shkak të gjendjes së rëndë financiare dhe shëndetësore nuk mund të përmbushë detyrimin. Në datën 23.7.2015, debitori i është drejtuar

përmbaruesit gjyqësor duke shprehur vullnetin për ekzekutimin e detyrimit në shumën 1000 lekë, që do të merret çdo muaj nga pensioni i debitorit. Në përgjigje të kërkesës, përmbaruesi gjyqësor ka sqaruar se ai si përmbarues nuk ka të drejtë të vendosë shlyerjen e detyrimit në këste dhe se ekzekutimi i detyrimit me shumën që debitori ofron çdo muaj do të çonte në zgjatjen e afatit të ekzekutimit të detyrimit për më shumë se 6 vjet.

19. Në datën 3.9.2015, përmbaruesi gjyqësor ka përpiluar një procesverbal për veprimet e kryera, sipas të cilit kërkuesi ka kërkuar likuidimin e detyrimit nga subjekti i interesuar Kalosh Vata me shumën 5 mijë lekë për çdo muaj deri në përfundim të detyrimit. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar është shprehur se është në pamundësi financiare, por do të bëjë të gjitha përpjekjet për likuidimin e shumës. Përmbaruesi privat gjyqësor, me shkresat nr. 243 prot., datë 21.3.2016, nr. 275 prot., datë 18.4.2017, dhe nr. 372 prot., datë 25.5.2017, i është drejtuar Komisarariatit të Policisë Mat dhe Bashkisë Mat me kërkesë për mbështetje gjatë inventarizimit të sendeve të luajtshme që ndodhen në banesë, me qëllim përcaktimin e pjesës takuese për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

20. Për sa u përket sjelljeve dhe veprimeve të kërkuesit, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave rezulton se ai ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

21. Lidhur me sjelljen e debitorit, Gjykata konstaton se ai ka shprehur vullnetin për ta shlyer borxhin, por për shkak të gjendjes së rëndë financiare nuk e ka plotësuar deri në momentin e paraqitjes së kërkesës para Gjykatës Kushtetuese.

22. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se në çështjen konkrete përmbaruesi gjyqësor privat ka kryer veprimet e parashikuara nga ligji për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Si rrjedhojë, Gjykata çmon se nuk jemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasoje e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor, për shkak të mosveprimit të debitorit apo të përmbaruesit gjyqësor privat, pasi ata kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

KËRKESË

Shtetësja Eda Bruzja kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Bruzja, i datëlindjes 31.8.1968.

KËRKUESE
Eda Bruzja

KËRKESË

Shtetasi Neço Rondo kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Petro Rondo, i datëlindjes 14.11.1910.

KËRKUES
Neço Rondo

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë